



PRANUAR MË:
ACCEPTED ON: 06/07/2021.
PRIMLJENO:
Nr.No.Br. 04/575



Republika e Kosovës
Komuna Malishevës

PROCESVERBAL

RENDI I DITES

Diskutim publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2022-2024

Mbledhja u mbajtë me datë: 25.06.2021 dhe filloi në ora 13:30.

Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin: 18 antarë të OJQ-ve dhe bizneseve, drejtorë komunalë si dhe zyra për informim.

Valon Mazreku: Ne jemi në fazën fillestare të përpilimit dhe hartimit të buxhetit dhe në këtë fazë buxhetit i paraprinë korniza afatmesme buxhetore e cila ndërtohet mbi bazën e udhëzimeve të cilat i përcakton ministria financave përmes qarkorës buxhetore 2022. Në kuadër të kësaj qarkore ne ikemi përgadit dhe qarkoren e mbrenshme buxhetore komunale dhe ju kemi dërgu të gjitha drejtorive komunale për me i paraqitë kërkesat e tyre, ajo që vlenë të ceket është se për vitin 2022 e kemi një rritje rreth 528.800 euro ose 3.75% në krahasim me vitin aktual që jemi ndërsa viti 2023 dhe 2024 faktikisht vrehet një rritje më e madhe në raport edhe me vitin 2022 edhe me vitin 2021 mirpo kjo shpërndarje nuk është definitive pasi që kjo rregullohet gjithmonë në vitin pasues. Ajo që është e saktë është që në vitin 2022 do ta kemi një buxhet prej 15.655.757 euro 3.75% më shumë se në vitin 2021 kjo rritje është pasqyru në dy programe ekonomike në programin e Administratës së përgjithshme e kemi një rritje pre 6.02% ose prej 317,617 euro dhe në programin e Arsimit 211,222 euro ndërsa granti i Shëndetësis nuk është rritë por as nuk është zvoglu dmth ka mbetë i njëjtë. Ne i kemi publiku edhe kornizën afatmesme këto mjete këtë total të buxhetit e kemi shpërnda në 5 kategori ekonomike duke u bazuar në ndarjen ose shpërndarjen siq e kemi në këtë vit të kategorive ekonomike duke e shtuar plus rritjen që është bërë prej 530.000 përafersisht që e kemi shpërnda në disa programe të kategorive ekonomike. Komuna jonë në Administratën publike duke përfshirë administratën komunale, Arsimin dhe Shëndetësinë i kemi 1297 të punsuar për këta të punsuar kategoria e pagave është 8,591,643 euro ndërsa kategoria mallrave dhe shërbimeve i kemi 1,679,730 euro kategoria e shpenzimeve komunale që i paguan komuna 455.000 euro, subvencione i kemi planifikuar 400.000 euro dhe investime kapitale 4,529,384 euro nëse e krahasojme me shpërndarjen e vitit aktual rritjen e kemi pasqyru kryesisht tek kategoria e investimeve kapitale ndikuar rreth 400.000 euro i kemi rritë investimet kapitale për vitin 2022.

Në kuadër të këtyre ne ju kemi ftuar që edhe ju të jeni pjesë e procesit të hartimit të buxhetit duke i parashtru kërkesat dhe nevojat tuaja unë nuk po e zgjas më shumë fjala është e juaja kush dëshiron me marrë fjalën atehëher urdhroni.

Hidajete Mazreku: Sa i përket buxhetit, mjetet buxhetore duhet që qytetarët të jenë të vetdijshëm dhe ta dinë rendësinë e përpilimit të buxhetit ose kornizës buxhetore 2022-2024 se në bazë të këtij planifikimi atëherë edhe ndahen mjetet për ato kategori që i kemi dhe ndahet edhe buxheti i komunës së Malishevës. Mirëpo unë pasi që jam asambleiste dhe i kam përcjellë të gjitha nga 2017 deri 2021 dhe kam pasë shumë vrejte mirëpo te buxheti që përpilohet me dëgjimi publik ka një rëndësi të madhe jo vetëm për qytetarët por edhe neve si kuvend. Më vjen mirë që sivjet i keni nda subvencionet sepse viteve tjera nuk kemi pas shumë subvencione si në biznese ashtu edhe në sektorët e tjerë kërkojë që tani të subvencionohen bizneset e grave dhe të përkrahen me grante po ashtu kërkoj që te përkrahet qendra rinore dhe rinia e komunës së Malishevës pasi që është resursi më i madh i komunës tonë po ashtu kam një vrejte rreth transparencës sepse kemi arritur në pikën zero sa i përket transparencës.

Mehreme Gërguri Krasniqi: Jam antare nga KDI nga qendra rinore në Rahovec jam monitoruese për transparencë për Rahovec, Malishevë dhe Gjakovë deshta mu nderlidhë me këtë zojën asambleiste dhe me juve drejtor që thatë se komunat nuk janë të obliguara me i mbështetë OJQ-të, komunat janë të obliguara me i mbështetë OJQ-të faktikisht është ligji por në kuadër të ligjit të ministrisë së punës dhe mirëqenies sociale ceket se komunat janë të obliguara me i subvencionu OJQ-të varësisht nga niveli i buxhetit të komunës.

Zymer Telaku: Përfaqësoj disa OJQ përfaqësoj klubin e futbollit "Top Besa" të volejbollit "Malisheva" dhe shoqatën e pedagogëve sportit shkollor dhe deshta tju drejtohem juve si hartues i buxhetit sepse faktikisht sa i përket buxhetit për OJQ dhe organizata që zhvillojnë aktivitete sportive unë mendoj që nuk po përcillet me trendin e rritjes sepse OJQ-të cdo ditë e më shumë po rriten por buxheti për to përafersisht është i njëjtë dhe shpesh ndodh me qenë me i vogël se sa ka qenë vitin paraprak. Po ashtu në rregullorën për mbështetje financiare kam pa dhe studiu mirë që është vazhdimisht duke u bërë shkelje dhe nuk ka vlersim real sa i përket aktiviteteve. Kërkojmë monitorimin e OJQ-ve dhe vlersimin e tyre në mënyrë që të financohen në bazën e kritereve dhe aktiviteteve që ato bëjnë e jo të financohen ato OJQ që aktivitetin e kanë zero.

Klubi i futbollit dhe klubi i volejbollit vajzat U16 e kanë za vendin e parë në nivel të Kosovës. A jeni të informun ju institucionet dhe ju OJQ se klubi i volejbollit është kualifikuar në ligën e parë, a ka datë historike për këtë aka mbështetje morale dhe financiare për këtë? Faleminderit.

Feride Hoxha: Jam menagjere e qendrës së rehabilitimit "Hendikos" në Malishevë unë dua tju falënderoj për këtë bashkëbisedim me shoqërinë civile por ni diqka që pata me tha hiqne nga fjalori fjalën që komuna nuk e ka obligim me i mbështet OJQ dhe shoqërinë civile unë do të flas më shumë për organizatën që unë e udhëheqi është një organizatë më e veçantë është një organizatë që ofron kryesisht shërbime unë e falënderojë cdo kund që 20 vite që na ka mbështetë por nëse ndalemi tek ankesat e fëmijve që kanë mbetë me dëmtime dhe kanë mbetë te shpija pa kurrfar shërbimi do te thotë na kemi vend për ankesa por kur të bahet shpërndarja buxhetit unë ju kisha kërku me pasë parasysh se është një pjesë e shoqërisë e cila kërkon trajtim nëse ne si organizatë nuk mund te ofrojmë ato shërbime atëherë si qeverisje ju e keni obligim sepse fëmija me aftësi të kufizuara është i barabartë me të gjitha të drejtat si fëmijët tjerë sepse i duhet subvencion për të marrë një fizioterapi. Nëse komuna na mbështetë me shumën prej 30,000 euro e cila është për 1 vit atëherë ato kthehen 3 fish sepse për një fëmijë një fizioterapi kushton 10 euro ne kemi ba falas, transportin e kemi ba falas kjo falë mbështetjes së komunës së Malishevës e mu mvjen keq që sivjet nuk kemi pasë mbështetje por kërkojë nga ju të gjeni një farë mënyre të financimit të këtyre shërbimeve të fizioterapisë faleminderit komunës së Malishevës e cila cdo herë përveq këtë vit na keni përkrahur. Faleminderit.

Valon Mazreku: Faleminderit zonja Feride mu pom vjen keq, por ne i kemi nda mjetet dhe ikemi të buxhetune në kuvend po si ka ardhur deri te kjo neglizhencë unë nuk ikam informacionet ne do të shofim a do të kemi mundësi me nda subvencione në kuadër të shëndetësisë për shërbime sociale, patjetër që ne jemi me i ndihmu te gjithë atyre fëmijëve dhe atyre familjeve që kanë raste të tilla të paktën edhe ata me i integru në kuader të shoqërisë.

Zoja Telaku: Për fat tmirë që ne egzitojmë si biznes nga viti 2016 dhe kemi pasë mbështetje por tani populli është vetdijësu dhe është duke kërkuar cilësi prandaj sa kemi kërkesë nuk kemi kapacitet me e mbulu kërkesat e konsumatorve andaj kërkojmë nga ju përkrahje në mënyre që te zhvilloj këtë biznes ne mënyrë që të mbulojmë tregun e Malishevës sepse kemi kërkesa të mdha pra kërkoj mbështetje ndonjë grant apo subvencion faleminderit.

Mehdi Krasniqi: Jam zyrtar për rininë, jam i thirrur me mbrojtje rininë dhe jo institucionet, ju bëj thirrje që në vitin 2022 në kornizën afatmesme buxhetore qështja është që për planin e veprimit rinor lokal nuk janë nda mjetet financiare pavarësisht që kuvendi komunës ka marrë vendim ashtu që në qoftë se nuk ka pasë mjete në dispozicion pikërisht drejtoria juaj është dashtë të thotë që nuk ka mjete financiare dhe plani i veprimit mundësia është ka me u shty për tash ose edhe për më vonë por asnjë qështje nuk është ngritë atje dhe plani veprimit rinor lokal po stagnon 13000 euro janë në këtë vit. Në qoftë se komuna nuk ka buxhet me i nda 13000 euro për rininë nuk e di pse thotë që ne jemi komunë, sa i përketë mbështetjes financiare për OJQ unë sjam ktu me mbrojtje drejtorinë përgjegjëse është zyra e kryetarit dhe jo drejtoria për Kulturë rini dhe sport. Ju bëj thirrje dhe ju lus që të ndani mjetet për planin e veprimit rinor lokal edhe nuk jam i knaqur me qështjet që aktivitetet e zyrtarve të komunës po bartën te OJQ-të nuk e di qëllimin pse bartën ku nuk ka naj bazë ligjore të bartën tek OJQ-të tash po del që OJQ-të po punojnë zyrtarë po rrinë për këtë jam shumë i shqetësuar. Sa i përket buxhetit drejtoria juaj përkatesisht drejtoria financiare duhet tju dërgojë drejtorive tjera vetëm tavanin buxhetor në mënyrë që drejtoritë tjera ta ndajnë ne prioritetet dhe shpenzimi buxhetor në fund të vitit ka me dalë 100%.

Kërkoj që plani i veprimit rinor lokal të përfshihet në kornizën afatmesme buxhetore 2022-2024.

Valon Mazreku: Kjo i nderun mu pom vjen keq prej teje se ti je zyrtar i komunës dhe ktu po i adreson qështjet që do të duhej ne mi diskutu brenda për brenda komunës dhe sa i përket hartimit të buxhetit drejtoria financiare ju ka dërgu të gjitha drejtorive qarkorën buxhetore sikur cdo vit tjetër edhe në kuder të qarkorës buxhetore të gjitha drejtoritë i paraqesin kërkesat e tyre në bazë të planit të punës së tyre edhe plani veprimit lokal do të duhej mu planifiku në buxhet nuk e di a e ki buxhetin e drejtorisë së kulturës vetëm investime kapitale në drejtori të kulturës janë mbi 100.000 euro. Buxheti për drejtorinë e kulturës për subvencione ku i kemi mbështet më shumë OJQ-të përmes drejtorisë së kulturës për shërbime kulturore janë 20.000 euro të planifikume ,20.000 euro janë të destinuar për rininë, dhe për sportin janë 40,000 euro të planifikuar që në total me i mledh bëjnë 80.000euro janë subvencione vetëm për drejtorinë e kulturës.

Mehreme Gërguri Krasniqi: Pasi që jam vetëm monitorues këtu edhe po shohum gjithqka këtu në mënyrë të barazume si nga ana komunës si nga ana ktyre po mundohna me gjetë atë balancin edhe pse këto janë informatat e para që po i marr prej këtij zyrtarit që tha nese drejtoria e tij nuk e zbatojnë at planin 7000 euro ose 10.000euro ku po shkojnë qato pare nëse ky si zyrtar nuk ika ba ato aktivitete kjo është pyetja ime?

Valon Mazreku: Faleminderit nga të gjithë që ndatë kohën me marrë pjesë në këtë ndëgjim publik të kornizës afatmesme buxhetore për vitin 2022-2024 besoj që prap kemi me ba mbledhje tjera sa i përket kësaj kornizes shihemi në takimin e radhës.